



Primitur / Dorezuar Prilbena / Prodato Received / Delivery	28.04.2023	3	viti god Year
Organ / Njesia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSTARI	3938/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 517/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.517/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çeshtjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.517/2023 e datës 16.03.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (me tej vetëm ankuesja), e punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, më datë 16.03.2023 ka parashtruar ankesë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me pretendimet që pozita që bazuar në kualifikimin dhe përvojën e ankueses si dhe nivelin e përgjegjësisë së pozitës që ushtron, e njëjta duhet të kategorizohet klasën profesional 1 e jo në profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 31.03.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja është e punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 04-052-748 të datës 09.11.2017 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Zyrtare për Statistika të Transportit dhe Telekomunikimit*, me koeficient shtate (7) të pagës, ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja në listën e pagave të muajit shkurt është kategorizuar në klasën profesional 2.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së bazuar në kualifikimet dhe përvojën e ankueses si dhe përgjegjësinë e detyrave të punës pozita e ankueses është e barasvlershëm me klasën profesional 1, e jo profesional 2 ashtu siç është propozuar nga organi i punësimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizim i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Statistikave të Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të

përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë profesionale 2 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.517/2023

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Procesmbajtës



Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;